



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 309 Akti**

**Nr. 291 Vendimi**  
**Tiranë, më 4.9.2020**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Suela Zhegu** Kryesuese  
**Lulzim Hamitaj** Relator  
**Genta Tafa (Bungo)** Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 2.9.2020, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Vojsava Osmanaj**, me detyrë gjyqtare gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër, e cila në seancën dëgjimore publike, të datës 02.09.2020, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- i. Znj. Vojsava Osmanaj, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); dhe pranë (ish) Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).
- ii. Pika 4 e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.3.2019, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Lulzim Hamitaj dhe Genta Tafa (Bungo).
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe studioi të tre raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 – 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 20.3.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Suela Zhegu. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit znj. Vojsava Osmanaj, me vendimin nr. 2, të datës 04.08.2020, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Në datën 10.08.2020, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: rezultatet e hetimit kryesisht - duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën - për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të

Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.

- vii. Pasi u njoh me dosjen, subjekti i rivlerësimit paraqiti, brenda afatit të caktuar, shpjegimet e shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- viii. Në datën 25.08.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 2.9.2020, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, si dhe me pjesëmarrjen e vetë subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, znj. Vojsava Osmanaj ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, të cilat i ka paraqitur edhe me shkrim, së bashku me dokumentacion provues.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj, kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 02.09.2020 u mbyll, për të rifilluar më 04.09.2020, për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ); (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

### VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-JA

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar pasuritë, si vijon:

- i. **Apartament banimi në Pogradec, me sipërfaqe 78.5 m<sup>2</sup>, ndodhur në ZK \*\*\*,** blerë me kontratën e shtblerjes me Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\*Kol, datë 25.03.2013, me vlerë prej 3,000,000 Lekë, në pronësi;
- ii. **Autoveturë e llojit A- Class 160, viti i prodhimit 2000,** blerë me kontratën e datës 09.05.2012, me vlerë 1,000 Euro;
- iii. **Kursime në banesë në vlerën 400,000 Lekë,** me burim kryesisht nga të ardhurat nga projektet e paguara *cash* në dorë;
- iv. **Gjendje në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank, në masën 1,035,670 Lekë,** me burim nga paga, dieta, pensioni i vajzës si dhe nga të ardhura nga mësimdhënia.
- v. **Të ardhura dhuratë në masën 4,000 Euro nga motra dhe vëllai në vitin 2007, të dhëna dhe të shpenzuara në vazhdimësi deri në vitin 2009,** përkatësisht 2,500 Euro nga motra Ç. O., derdhur në llogari bankare në Raiffeisen Bank dhe 1,500 Euro nga vëllai M. G., dorazi.

### RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

#### 1. Apartament banimi me vendndodhje në Pogradec, me sipërfaqe 78.5 m<sup>2</sup>, me vlerë 3,000,000 Lekë.

1. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP të vitit 2012, sipas aktit të premtimit për shitje me Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 30.03.2012, si dhe pagimi i shumës prej 1,000,000 Lekë. Komisioni ka konstatuar se akti premtim për shitje i paraqitur nga subjekti

i rivlerësimit me dokumentacionin e bashkëngjitur Deklaratës vetting, si dhe në përgjigje të pyetësorit nr 2, kishte referencat Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol dhe mban datën 08.03.2013, ndryshe nga ato të përshkruara në vitin 2012.

2. Komisioni, për të qartësuar këtë mospërputhje të dhënash të aktit të lartpërmendur, iu drejtua noterit hartues, z. S. R. me anë të shkresës Nr. \*\*\* Prot., datë 03.07.2020, duke e ftuar që të vendoste në dispozicion aktin noterial të premtim shitjes Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 30.03.2012. Nga akti i përcjellë nga noteri, me përgjigjen e datës 09.07.2020, ka rezultuar se znj. F. Ç. në cilësinë e bashkëpronares së truallit<sup>1</sup>, do të përfitonte një apartament me sipërfaqe rreth 74.84 m<sup>2</sup>, të cilin ka premtuar t'ia shesë subjektit të rivlerësimit, kundrejt çmimit total prej 3,000,000 Lekë. Kësti i parë prej 1,060,000 Lekë do të paguhej nëpërmjet BKT-së në datën 02.04.2012 në llogari të palës shitëse dhe diferenca prej 1,940,000 Lekë, me marrjen e një kredie si e pastrehë<sup>2</sup>.
3. Në DIPP të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën përkatëse të detyrimeve nënshkrimin e kontratës së huasë Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, në datë 23.03.2012, pa interes, në shumën 1,000,000 Lekë të marrë nga shtetasi M. M. Ndërsa, në DIPP të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar nënshkrimin e kontratës së shitblerjes Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 25.03.2013, me palë shitëse znj. F. Ç. dhe palë blerëse znj. Vojsava Osmanaj për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 78.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në ZK \*\*\*, Pogradec, në shumën 3,000,000 Lekë. Po ashtu, në rubrikën përkatëse të detyrimeve të DIPP-së së vitit 2013, subjekti ka deklaruar marrjen e kredisë bankare pranë BKT-së në shumën prej 1,938,000 Lekë, me qëllim blerjen e apartamentit në analizë.
4. Komisioni ka konstatuar se në Deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të apartamentit në fjalë, por ka cituar që, pasuria është aktualisht e hipotekuar në favor të bankës BKT për efekt të kredisë bankare. Gjithashtu, në rubrikën e detyrimeve financiare të kësaj Deklarate, ajo ka deklaruar marrjen e kredisë pranë BKT-së, dhe vazhdimin e shlyerjes së saj, si dhe huanë e marrë e të shlyer ndaj huadhënësit, z. M. M., - shumë e cila po ashtu ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e këtij apartamenti.
5. Në pyetësorin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime për arredimin dhe mobilimin e këtij apartamenti ndër vite në shumën totale 400,000 Lekë, nga të cilat 209,000 Lekë<sup>3</sup> janë shpenzuar në vitin 2018 dhe diferenca është shpenzuar gradualisht ndër vite nga momenti i blerjes<sup>4</sup>.
6. Pasi është pyetur nga Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr 2, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shtetasi M. M. është njerku i saj<sup>5</sup>, i cili është përkujdesur, që në moshë shumë

<sup>1</sup> Konstatohet se ky apartament në momentin e nënshkrimit të aktit të premtim shitjes së vitit 2012 nuk ka qënë ende i regjistruar në ZVRPP. Referuar kartelës së pasurisë, ky apartament është regjistruar në datë 19.12.2012 dhe çertifikata e pronësisë në emër të pales shitëse F. Ç. (R.) është lëshuar në datë 17.01.2013.

<sup>2</sup> Nuk u konstatuan ndryshime në marrëveshjen midis palëve sa i përket çmimit apo pagesave/ndarjes së kësteve, ndërmjet aktit të premtim shitjes së vitit 2012 me atë të vitit 2013.

<sup>3</sup> Subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion dy fatura tatimore përkatësisht fatura Nr. \*\*\*, datë 25.12.2018 për blerjen e artikujve frigorifer, lavatrice dhe sobë me dru në shumën totale 61,000 lekë dhe fatura Nr. \*\*\*, datë 27.12.2018 për blerjen e artikujve dhomë gjumi, kuzhinë, etazher dhe portmanto në shumën totale 148,000 Lekë.

<sup>4</sup> Këto shpenzime në masën 191,000 Lekë, për efekt të analizës financiare, duke qënë se subjekti i rivlerësimit nuk ka banuar në këtë apartament, janë shpërndarë në sasi të barabartë ndër vite, duke filluar nga viti 2013 që është blerë pasuria.

<sup>5</sup> Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur pyetësorit nr 2, çertifikatën familjare të datës 27.02.1992, në të cilën bëjnë pjesë Kryefamiljari M. M., bashkëshortja L. M., djemtë M. O. dhe R. M. dhe vajzat Vojsava dhe Ç. O.

të vogël dhe se huaja është nënshkruar vetëm prej tij në cilësinë e huadhënësit, por shuma e lekëve kanë qenë kursime familjare të të dyve, nënës dhe bashkëshortit të saj ndër vite. Kontrata e huasë është nënshkruar vetëm prej tij, pasi ai e ka ndihmuar në të gjithë procedurat deri në blerjen e apartamentit. Gjithashtu, bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka depozituar një deklaratë të thjeshtë<sup>6</sup>, të datës 16.05.2020, në të cilën shtetasit M. M. dhe L. M. kanë deklaruar se i kanë dhënë hua subjektit të rivlerësimit në vitin 2012, shumën prej 1,000,000 Lekë dhe se shlyerja e saj është bërë dorazi çdo muaj në shumën 20,000 Lekë dhe ka përfunduar në muajin prill 2016.

7. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
- i. ASHK Pogradec, me anë të shkresave Nr. \*\*\* Prot, datë 22.09.2017 dhe Nr. \*\*\* Prot, datë 20.05.2020 ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit Vojsava Osmanaj rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme e llojit apartament me nr. pasurie \*\*\*, vol \*\*\*, faqe \*\*\*, ndodhur në ZK \*\*\*, Pogradec, me sipërfaqe 78.5 m<sup>2</sup>.
  - ii. Çertifikatë pronësie lëshuar më datë 25.03.2013, për pasurinë apartament me nr. pasurie \*\*\*, të ndodhur në Pogradec, regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.
  - iii. Akt - premtim shitje Nr. \*\*\* Rep dhe Nr. \*\*\*, datë 08.03.2013, në të cilin F. Ç. (R.) premtim ti shesë subjektit të rivlerësimit, pasurinë e llojit apartament me nr. pasurie \*\*\*, të ndodhur në Pogradec, kundrejt çmimit total prej 3,000,000 Lekë. Sipas kontratës, kjo shumë do të paguhej me 2 këste, përkatësisht *kësti i parë* në shumën 1,060,000 Lekë e paguar nga ana e blerësit në datën 02.04.2012 nëpërmjet B.K.T Dega Pogradec dhe *kësti i dytë* në shumën 1,940,000 Lekë, do të paguhej nëpërmjet B.K.T Dega Pogradec, nga kredia që do të përfitonte subjekti i rivlerësimit si e pastrehë.
  - iv. Kontratë shitje Nr. \*\*\* Rep dhe Nr. \*\*\* Kol, datë 25.03.2013, lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe palës shitëse F. Ç., për blerjen e apartamentit në Pogradec me sipërfaqe 78.5 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit total prej 3,000,000 Lekë. Sipas kontratës, çmimi është likuiduar nga ana e palës blerëse nëpërmjet BKT-së<sup>7</sup>.
  - v. Kontratë huadhënie me Nr. \*\*\* Rep dhe Nr. \*\*\* Kol, datë 23.03.2012, e lidhur midis shtetasit M. M. në cilësinë e huadhënësit dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huamarrëses së shumës prej 1,000,000 Lekë, shumë kjo e dhënë jashtë zyrës noteriale, pa interes dhe me një afat kthimi prej 4 vjetësh. Në këtë kontratë është cituar se kthimi i huasë do të kryhej në 48 këste nga 20,000 Lekë në muaj.
  - vi. Bashkia Pogradec me shkresën Nr. \*\*\* Prot, datë 19.05.2020, ka vënë në dispozicion praktikën e aplikimit në projektin për subvencionimin e interesave të kredisë, ku është bashkëngjitur Vendimi i Keshillit Bashkiak Pogradec Nr. \*\*\*, datë 25.11.2011 “*Për miratimin e listës emërore të fituesve që kanë aplikuar sipas ligjit Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave rurale”*”, së bashku me listën emërore nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit është përfitues<sup>8</sup>.

<sup>6</sup> Jo në prani të noterit.

<sup>7</sup> Rezulton të jetë nënshkruar edhe Deklarata noteriale Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 25.03.2013 nga shtetasi V. Ç., i cili ka deklaruar dakordësinë për shitjen e apartamentit të mësipërm nga ana e bashkëshortes së tij F. Ç. (R.). Kjo deklaratë është pjesë e dosjes së kredisë, ardhur nga BKT me anë të shkresës Nr. \*\*\* Prot, datë 14.11.2019.

<sup>8</sup> Vojsava F. Osmanaj gjendet në nr. 27 të listës emërore dërguar BKT-së me shkresën Nr. \*\*\* Prot, datë 12.01.2012, me përbërje familjare prej 3 personash, struktura e apartamentit që përfiton është 1+1 dhe vlera maksimale e apartamentit që

- vii. BKT me shkresën Nr. \*\*\* Prot, datë 12.05.2020, ka vënë në dispozicion kontratën e kredisë bankare Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 30.03.2013, lidhur ndërmjet kredihënësit BKT dhe kredimarrësit Vojsava Osmanaj e dorëzanësit Ç. O.<sup>9</sup>, për marrjen e kredisë në shumën 1,938,000 Lekë, me objekt “Blerje shtëpie”<sup>10</sup> si dhe kontratën e hipotekimit Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 30.03.2013 për hipotekimin e apartamentit në fjalë, për sigurimin e kredisë.
- viii. Vërtetim nga BKT Dega Pogradec Nr. \*\*\* Prot, datë 20.01.2017, në të cilin kjo e fundit ka konfirmuar shumën e mbetur të kredisë së sipërcituar, në datën e vërtetimit, prej 1,734,326.76 Lekë, shumë e cila përputhet me deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën vetting.

### 1.1. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie:

- 8. Në DIPP të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim financiar për pagesën e këstit të parë prej 1,000,000 Lekë, për këtë pasuri, huanë e marrë nga shtetasi M. M., sipas kontratës së huasë Nr. \*\*\* Rep dhe Nr. \*\*\* Kol, më datë 23.03.2012.
- 9. Nga lëvizjet e llogarive bankare është konfirmuar se në datën 02.04.2012, subjekti i rivlerësimit ka derdhur *cash* në llogarinë e saj pranë BKT shumën prej 1,061,500 Lekë, nga e cila 1,060,000 Lekë<sup>11</sup> është transferuar në llogari të palës shitëse F. Ç., në të njëjtën datë, me përshkrimin “*Likuidim kësti për blerje apartamenti*”. Ndërsa në datën 04.04.2013 është disbursuar kredia në shumën 1,938,000 Lekë, e cila është transferuar gjithashtu në llogari të palës shitëse në datën 08.04.2013.
- 10. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, - z. M. M. dhe nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. L. M., - për dhënien e huasë prej 1,000,000 Lekë, në favor të subjektit të rivlerësimit, në prill të vitit 2012, është vënë në dispozicion, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, dokumentacioni si më poshtë:
  - i. Çertifikatën e regjistrimit të aktivitetit të shtetasit M. M. si Person Fizik, me Nr. NIPT \*\*\* dhe pagesat e sigurimeve shoqërore.

përfiton është 2,423,288 Lekë. Praktikës i janë bashkëngjitur edhe dokumentat e aplikimit të subjektit të rivlerësimit, si çertifikata familjare (e përbërë nga Vojsava, A. dhe Ç.), vërtetim banimi në Pogradec dhe vërtetim nga ZRPP që nuk kanë pasuri të regjistruar në Pogradec.

<sup>9</sup> Ç. O. (motra e subjektit të rivlerësimit) në periudhën 2011- 2013 është deklaruar në DIPP-të përkatëse, të ketë qënë pjesë në çertifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit. Ajo është përfaqësuar në kontratën e kredisë nga Vojsava Osmanaj, me anë të prokurës së posaçme Nr. \*\*\* Rep dhe Nr. \*\*\* Kol, datë 12.04.2012.

<sup>10</sup> Kontratë e lidhur në bazë të Nenit 1031 e në vazhdim të Nenit 560 e në vazhdim të Kodit Civil, të Ligjit Nr. 9232, datë 13.05.2004 “*Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane*”, i ndryshuar; VKM Nr. 600, datë 12.09.2007 “*Për trajtimin me strehim të nënpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politik*”; Udhëzimit Nr 6257, datë 02.09.2008 “*Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti*”, si dhe të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave Nr 10240/1, datë 17.10.2008 “*Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti*”, Marrëveshjes Tripalëshe datë 18.02.2009. Referuar kësaj kontrate kredie, norma e interesit që do të paguhet nga kredimarrësi do të jetë 3 (tre) %, përsa kohë shumata totale e interesit të subvencionuar nuk kalon totalin e vlerës së pronës objekt blerje të përcaktuar në kontratën e shitjes (në asnjë rast kjo vlerë nuk do të jetë më e lartë se vlera e apartamentit të përcaktuar nga MPTT për këtë klient), e barazvlefshme me 2,461,500 Lekë.

<sup>11</sup> Nuk rezultoi të jetë paraqitur dokumentacion për shlyerjen e shumës së mbetur prej 2,000 Lekë ndaj palës shitëse, për plotësimin e çmimit total prej 3,000,000 Lekë për blerjen e apartamentit, shumë e cila duhet të jetë likuiduar *cash* nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 2013, sipas ndarjes së kësteve në aktin e premtimit të shitjes.

- ii. Vërtetimin nga ISSH Korçë Nr. \*\*\* Prot, datë 05.04.2020, ku L. M., rezulton të ketë përfituar pension nga vitit 2008 e në vijim.
- iii. Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetas L. G. (M.) nga viti 1994 deri në vitin 2007.
- iv. Vërtetim për bazën e vlerësuar për të vetëpunësuarin M. M. për periudhën prill 2009 deri në vitin 2012.
- v. Vërtetim Nr. \*\*\* Prot, datë 25.03.2019 nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në të cilin është dhënë informacion mbi tatimin dhe taksat vendore të paguara nga M. M., Person Fizik për periudhën 2009 deri në 2013, por nuk janë paraqitur të dhëna mbi fitimin e realizuar nga ky aktivitet.
- vi. Librezë depozite nga Tirana Bank të shtetasit M. M., në të cilën rezulton se në datën 01.02.2012 ai ka tërhequr shumën prej 2,794 Euro, të cilën së bashku me kursimet e tyre *cash* ja kanë dhënë subjektit të rivlerësimit<sup>12</sup>.

11. Subjekti i rivlerësimit ka shtuar në shpjegimet e veta se prindërit kanë përfituar gjithashtu të ardhura nga motra e saj kur ajo vinte në Shqipëri si dhe nëpërmjet transfertave bankare. Ajo ka vënë në dispozicion dokumentacionin e dy rasteve, një në vitin 2010 ku nëpërmjet Bankës Uni Credit në Itali, motra e saj ka transferuar në datë 18.03.2010 në llogarinë e babait (njerikut) M. M. shumën prej 3,490 Euro, si dhe një transfertë e datës 09.04.2015 ku i ka dërguar nënës së subjektit të rivlerësimit L. M. shumën prej 2,490 Euro, nga shqyrtimi i të cilave Komisioni ka konstatuar se transferta e vitit 2010 është e dërguar nga ana e njerikut të subjektit të rivlerësimit në favor të motrës së kësaj të fundit dhe si rrjedhojë kjo shumë nuk është marrë në konsideratë në analizën e kryer për prindërit e subjektit Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se përveç të ardhurave të dokumentuara me aktet sa më lart, nëna e saj ka realizuar për shumë vite dhe kurse private për firzamonikë, vegël muzikore të cilën ajo për shkak të shkollimit e ka zotëruar shumë mirë.

12. Nga Ekstrakti historik në QKB<sup>13</sup>, ka rezultuar se z. M. M. ka ushtruar aktivitetin Bar-bufe të ndodhur në Pogradec, aktivitet i cili është regjistruar në datë 24.04.2009 dhe është çregjistruar në maj të vitit 2014. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, ka informuar me anë të shkresës Nr. \*\*\* Prot, datë 24.08.2017, se shtetasi M. M. ka realizuar gjatë vitit 2010 të ardhura në masën 1,860,000 Lekë dhe në vitin 2011 të ardhura në masën 1,350,000 Lekë, por pa përcaktuar sa ka qënë fitimi neto i realizuar nga ky aktivitet. Gjithashtu, më pas po nga ky institucion, me shkresën Nr. \*\*\*, datë 02.06.2020<sup>14</sup>, janë vënë në dispozicion Formularët e deklaramentit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël M. M. Person Fizik, nga të cilat kanë rezultuar fitimet si më poshtë:

- i. Viti 2009 – të ardhurat dhe fitimi 0 Lekë.
- ii. Viti 2010 – të ardhurat 1,860,000 Lekë dhe fitimi pas tatimit 270,000 Lekë.
- iii. Viti 2011 – të ardhurat 1,350,000 Lekë dhe fitimi pas tatimit 300,000 Lekë.
- iv. Viti 2012 – të ardhurat dhe fitimi 0 Lekë.

<sup>12</sup> Referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetjes nr. 3, të pyetësorit nr. 2.

<sup>13</sup> www.qkb.gov.al

<sup>14</sup> DRT Korçë ka informuar gjithashtu se shtetasi F. B. Osmanaj (babai biologjik i subjektit të rivlerësimit) figuron i regjistruar prej datës 05.05.2010, me aktivitet inxhinier topograf si dhe rezulton aktualisht me status aktiv, me përgjegjësi tatimore Tatim i thjeshtuar mbi fitimin dhe TVSH.



13. Në vijim të analizës së dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe pas përlogaritjes së të ardhurave të familjes huadhënëse, për periudhën nga viti 2003 e deri në mars të vitit 2012, mundësia e prindërve të subjektit të rivlerësimit për të kursyer shumën prej 1,000,000 Lekë, që do të mundësonte më pas dhënien e saj si hua, në favor të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar si më poshtë:

Te ardhura nga paga L. M.	1,113,896
Te ardhura nga pensioni L.M.	931,064
Te ardhura nga paga M. M	421,050
Te ardhura nga aktiviteti M.M. PF	570,000
Shpenzime jetese (2003-Mars 2012)	(2,223,333)
<b>Mundesia e kursimit</b>	<b>812,677</b>
Dhene hua subjektit te rivleresimit	(1,000,000)
<b>Rezultati</b>	<b>(187,323)</b>

14. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar fillimin e shlyerjes së huasë<sup>15</sup> ndaj shtetasit M. M. duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2016, vit në të cilin ka deklaruar edhe përfundimin e shlyerjes së plotë të huasë në analizë, pikërisht në muajin prill të këtij viti, çka përputhet me mënyrën e kthimit të huasë të deklaruar edhe nga shtetasi M. M.

15. Ndërsa, lidhur me kredinë bankare, të deklaruar si burim për pagesën e këstit të dytë, për blerjen e apartamentit, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, është konstatuar se kontrata e shitblerjes së pasurisë të paluajtshme është nënshkruar në datën 25.03.2013 dhe në të është saktësuar nga palët se çmimi total prej 3,000,000 Lekë është likuiduar nga pala blerëse nëpërmjet BKT-së, ndërkohë që kontrata<sup>16</sup> e kredisë bankare është nënshkruar në datën 30.03.2013 dhe rezulton të jetë disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 04.04.2013. Shuma e kredisë prej 1,938,000 Lekë është transferuar më pas në llogari të palës shitëse F. Ç. dhe V. Ç. në datën 08.04.2013, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “*xhiruar kësti përfundimtar për blerje apartamenti*”.

16. Lidhur me faktin se kalimi i pronësisë së apartamentit është kryer përpara nënshkrimit të kontratës së kredisë, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se kalimi i pronësisë para nënshkrimit të kontratës së kredisë ka qënë një kusht i panegociushëm i bankës, e cila kërkonte me patjetër që në momentin e nënshkrimit të kontratës së kredisë, pasuria të figuronte e regjistruar në emër të kredimarrësit me qëllim ngrirjen e saj si garanci nëpërmjet kontratës së hipotekimit.

17. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 27.05.2020, lëshuar nga shtetasja F. Ç. (pala shitëse) e cila ka deklaruar se në vitin 2013, i ka shitur subjektit të rivlerësimit apartamentin në shumën 3,000,000 Lekë<sup>17</sup>

<sup>15</sup> Shuma 200,000 Lekë likuiduar në vitin 2012, shuma 240,000 Lekë në vitin 2013, shuma 240,000 Lekë në vitin 2014, shuma 240,000 Lekë në vitin 2015 dhe shuma 80,000 Lekë në vitin 2016.

<sup>16</sup> Konstatohet se apartamenti në këto kontrata, rezulton të jetë i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

<sup>17</sup> Ajo ka deklaruar se pagesa është bërë 1,000,000 Lekë dorazi në momentin e nënshkrimit të akt premtim shitjes, dhe pjesa tjetër është kaluar nëpërmjet BKT, në datë 08.04.2013, nga kredia që ajo kishte përfituar nga Bashkia Pogradec.

dhe se pronësia me mirëbesim dhe me një marrëveshje verbale që është bërë para bankës, ka kaluar para lëvrimit të shumës së kredisë dhe konkretisht në datën 25.03.2013 dhe se ky ishte një kusht i Bankës e cila nuk mund të lidhte kontratën e kredisë pa e hipotekuar më parë pasurinë përkatëse.

18. Në kontratën e kredisë së lidhur ndërmjet BKT-së dhe subjektit të rivlerësimit është konstatuar se qëllimi i kredisë është për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit në fjalë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe pavarësisht nënshkrimit në datë 25.03.2013 të kontratës së shitblerjes – në të cilën palët kanë deklaruar që likuidimi i çmimit total është bërë nëpërmjet BKT-së – shuma e kredisë prej 1,938,000 Lekë do të transferohej në favor të shitësve znj. F.Ç. dhe z. V. Ç.
19. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rregullisht çdo vit në rubrikën përkatëse të detyrimeve financiare në DIPP-të, shumën e shlyer për secilin vit ndaj BKT-së për kredinë si dhe detyrimin e mbetur.
20. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, Komisioni i ka njoftuar subjektin të rivlerësimit rezultatin e përmbledhur si më poshtë:

Duket se personi tjetër i lidhur, z. M. M. ka patur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën – 187,323 Lekë për dhënien e huasë në shumën prej 1,000,000 Lekë, në favor të subjektit të rivlerësimit, në vitin 2012. Kanë rezultuar mospërputhje midis përmbajtjes së kontratës së shitblerjes dhe kohës së kryerjes së pagesës së shumës të përfituar nga kredia bankare.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

21. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka kundërshtuar pjesërisht analizën financiare, dhe konkretisht lidhur me shumën totale të të ardhurave të përlllogaritura si të realizuara nga shtetasi M. M., në funksion të justifikimit nga ana e tij të mundësisë financiare për dhënien e huasë, në shumën prej 1,000,000 Lekë. Subjekti ka shpjeguar se në fakt, aktiviteti i huadhënësit ka nisur prej vitit 2000, si një biznes i vogël familjar i prindërve dhe është zhvilluar në katin e dytë të shtëpisë së tyre të banimit. Subjekti ka shpjeguar se mandatet e arkëtimit të kryera nga shtetasi M. M. faktojnë ekzistencën e aktivitetit të tij edhe përpara regjistrimit në vitin 2009 dhe në bazë të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, nga viti 2007 deri në vitin 2013 është zbatuar dispozita e nenit 11, pika 4, ku *“Niveli tregues i taksës, për çdo kategori biznesi, në varësi të qarkullimit vjetor, të ndarë sipas intervaleve prej 1 milion lekësh, duke filluar nga vlera minimale prej 2 milionë lekësh, jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, detyrimi fiskal tregues është i fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi”*. Duke u bazuar në marzhin e fitimit të realizuar nga aktiviteti i huadhënësit në vitet 2010 dhe 2011, subjekti ka përlllogaritur një fitim të mundshëm të këtij aktiviteti edhe për vitet 2005-2008, përpara regjistrimit të tij, në masën 1,440,000 lekë dhe përse kohë nga ana e tij rezultojnë të jenë paguar detyrime tatimore, këto të ardhura duhet të konsiderohen të ligjshme në kuptim të Ligjit nr. 84/2016 dhe të përfshihen në analizë.

22. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shtuar se shtetasi M. M. ka punuar si guzhinier në disa lokale dhe hotele ku kryeheshin edhe evente të ndryshme si dasma, etj, punë e cila në shumicën e rasteve ka qënë me kohë të pjesshme. Nisur nga faktin që kjo punë ka qënë e pasiguruar, ajo ka paraqitur dy deklarata noteriale për të faktuar sa më sipër ka pretenduar. Bazuar në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 6, “Detyrimet e personave që paguajnë kontributet”, përcaktohet se “Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur” si dhe “Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.” Në këto kushte, për sa kohë këto detyrime sipas përcaktimeve të Ligjvënësit, nuk rëndojnë mbi punëmarrësin, në këtë rast huadhënësi në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se edhe këto të ardhura të tij, në shumën prej 800,000 lekë, duhet të njihen si të ligjshme dhe të provuara dhe të përfshihen në analizën financiare. Lidhur me mospërputhjen e kohës së kryerjes së pagesës së shumës të përfituar nga kredia bankare, subjekti ka shpjeguar si më lartë është përshkruar.
23. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të argumentimit dhe pretendimit të lartpërpundur, ka depozituar pranë Komisionit, në cilësinë e provave të reja, dokumentacionin që vijon:
- i. Mandate arkëtimi nga z. M. M. për Ndërmarrjen e Taksave dhe Tregjeve në Bashkinë Pogradec, për pagesa të taksave vendore pastrimi, ndërtese, tabele dhe ndriçimi nga viti 2005 deri në vitin 2008 dhe pagesë taksë vendore për biznesin e vogël për vitin 2008.
  - ii. Deklaratë noteriale Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol datë 18.08.2020, e lëshuar nga shoqëria V. Xh., Person Fizik me NIPT \*\*\*, në të cilën ka deklaruar se gjatë periudhës qershor 2010 – qershor 2013, z. M. M. ka punuar me kohë të pjesshme në aktivitetin e tij si kuzhinier në evente dasmash dhe është paguar me një pagë prej 40,000 Lekë në muaj, por nuk ka qënë i siguruar, bazuar në marrëveshjen e palëve. Bazuar në këtë deklarim, subjekti i rivlerësimit ka bërë një përlllogaritje duke shtuar të ardhurat në masën 800,000 Lekë nga ky punësim, duke rezultuar se personat e tjerë të lidhur kishin mundësi për dhënien e huasë.
  - iii. Deklaratë noteriale Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 12.08.2020, e lëshuar nga shoqëria M. C., Person Fizik me NIPT \*\*\*, në të cilën ka deklaruar se nga viti 2014, z. M. M. ka punuar në aktivitetin e tij si kuzhinier në evente dasmash dhe është paguar me një tarifë prej 100 Lekë për person.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

24. Lidhur me mandatet e arkëtimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk rezultojnë të kenë të specifikuar se për cilin aktivitet janë kryer pagesat në fjalë si dhe aktiviteti i shtetasit M. M. rezulton të jetë regjistruar në Gjykatë dhe QKB në datën 24.04.2009. Po ashtu edhe NIPT përkatës mban të njëjtën datë lëshimi dhe regjistrimi. Edhe nga QKB edhe nga DRT Korçë, ky aktivitet nuk rezulton të ketë qënë i regjistruar përpara kësaj date, për rrjedhojë duket disi e komplikuar të pranohet ideja që mund të jenë paguar taksa për një/këtë aktivitet, për të cilin nuk rezulton regjistrimi dhe ekzistenca formale e tij në organet kompetente. Nga

kërkimet e bëra nga Komisioni, edhe në faqen e web të QKB- së, nuk ka rezultuar që në emër të z. M. M. të ketë patur ndonjë tjetër aktivitet, të ngjashëm por me të dhëna të ndryshme, përpara vitit 2009, për të cilin mund të ishin paguar prej tij detyrimet tatimore të referuara më sipër. Për më tepër, nëpërmjet mandat-pagesave të taksave vendore, të vëna në dispozicion të Komisionit, edhe nëse ato do të përkonin me periudhën e regjistrimit dhe me të dhënat e aktivitetit në fjalë, nuk do të arrihej të provohej niveli i xhiros së tij dhe as kristalizimi i fitimit të realizuar, i cili në çdo rast nuk mund të merrej në konsideratë si një burim i ligjshëm pa u provuar kryerja e pagesave të detyrimeve tatimore. Për sa më lart, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë burim nuk janë të provuara, dhe se këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare, për sa kohë nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni “D” i Aneksit të Kushtetutës.

25. Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga punësimi i z. M. M., me kohë të pjesshme në aktivitetin e shtetasit V. Xh., ka rezultuar se për këto nuk rezultojnë të jenë paguar detyrimet tatimore. Pavarësisht, pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e këtyre të ardhurave në llogaritjen e mundësisë së prindërve të saj, për dhënien e huasë prej 1,000,000 Lekë, referuar përcaktimeve të nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës, këto të ardhura mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mund të konsiderohen si një burim i ligjshëm.
26. Sa më lart, - duke evituar përsëritjen e argumentimit, - vlen edhe për pretendimin e subjektit lidhur me të ardhurat të realizuara nga punësimi i z. M. M., me kohë të pjesshme (në evente dasmash), në aktivitetin e shtetasit M. C. Për më tepër, rezulton se periudha nga viti 2014 e pas (e cituar në deklaratën noteriale të lartpërshkruar), është pas dhënies së huasë, në favor të subjektit të rivlerësimit në vitin 2012, dhe për rrjedhojë në çdo rast nuk do të mund të ishte përdorur si burim për huadhënien në analizë.
27. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se rezultati financiar, mbi mundësitë e huadhënësit, i njoftuar nga Komisioni, nuk mund të ndryshojë në sajë të dokumentacionit dhe të shpjegimeve të paraqitur/a nga subjekti i rivlerësimit dhe për rrjedhojë, se subjekti i rivlerësimit ka patur një mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në rezulton masën – 187,323 Lekë, në kuptimin e nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se kjo pamjaftueshmëri financiare, së bashku me pasaktësitë e konstatuara lidhur me këtë pasuri, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit vlerësohen të tolerueshme, pasi ato konsistojnë në një peshë minimale në raport me vlerësimin e çështjes në tërësi.

## **2. Autoveturë e lojit A- Class 160, viti i prodhimit 2000.**

28. Ky automjet është deklaruar për herë të parë në DIPP të vitit 2012 dhe më pas në Deklaratën vetting, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka përshkruar blerjen e automjetit të përdorur, të llojit Mercedes Benz, me vlerën 1,000 Euro, me anë të Kontratës së blerjes datë 09.05.2012, por në asnjërën prej këtyre deklaratave nuk është përcaktuar burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie.

29. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

- i. Me shkresën Nr. \*\*\* Prot, datë 04.11.2019, DPSHTRR ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka patur të regjistruar në pronësi automjetin me targë \*\*\*, të llojit Mercedes Benz A-160.
- ii. Kontratë shitblerje Nr. \*\*\* Rep dhe Nr. \*\*\* Kol, datë 05.05.2012, lidhur ndërmjet palës shitëse A. H. dhe palës blerëse Vojsava Osmanaj, me anë të të cilës subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin Benz A160 kundrejt çmimit 145,000 Lekë.
- iii. Akt-zhdoganimi i datës 05.05.2012 për zhdoganimin e automjetit në vlerën 30,823 Lekë, i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit tek personi përgjegjës.
- iv. Çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor Mercedes Benz modeli A160, viti i prodhimit 2000, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, e lëshuar në datë 09.05.2012.
- v. Kontratë shitblerje automjeti Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 07.06.2017, lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit në cilësinë e palës shitëse dhe palës blerëse R. D., në të cilën subjekti i rivlerësimit ka shitur automjetin e sipërcituar kundrejt çmimit 1,400 Euro.

### **2.1. Lidhur me analizimin e burimeve financiare të krijimit të kësaj pasurie:**

30. Subjekti i rivlerësimit, siç u tha edhe më lart, nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie as në DIPP të vitit 2012 dhe as më pas, në Deklaratën vetting, por referuar përgjigjeve të dhëna për këtë pasuri, pas nisjes nga Komisioni të pyetësorit nr. 2, veç të tjerash ka sqaruar se data e blerjes është një lapsus pasi data e saktë është ajo e shënuar në kontratë, ndërsa burimi i ligjshëm financiar i blerjes së këtij automjeti kanë qënë të ardhurat nga paga e saj<sup>18</sup>. Subjekti ka shpjeguar se nuk ka shënuar burimin e krijimit në deklaratat përkatëse, me mendimin se është një vlerë e vogël që nuk e kalon shumë prej 300,000 lekë shpenzim.

31. Nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka patur të ardhura neto nga punësimi gjatë vitit 2012 në masën 817,486 Lekë<sup>19</sup> dhe më poshtë është paraqitur në mënyrë të përmbledhur analiza e vitit 2012<sup>20</sup>, nga ku konstatohet mjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie:

---

<sup>18</sup> Nga lëvizjet bankare ka rezultuar se në datë 03.04.2012 (pas depozitimit të kështit të pare të blerjes së apartamentit në datë 02.04.2012), subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e saj bankare e pagës në Union Bank shumë prej 500,000 Lekë, gjendje kjo e krijuar me pagat dhe shpërblimet e saj, çka provon dhe mundësinë e disponibilitetit të shumës së shpenzuar për blerjen e automjetit, prej 145,000 lekë, në momentin e blerjes.

<sup>19</sup> Bazuar në Vërtetimin Nr. \*\*\* Prot, datë 11.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Korçë.

<sup>20</sup> Në të janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit, shpenzimet dhe investimet e kryera prej saj gjatë vitit 2012. Huaja e marrë nga shtetasi M. M. është konsideruar me burime të ligjshme në masën 812,677 Lekë, pas zbritjes së mungesës së konstatuar prej 187,323 Lekë.

Te ardhurat e vitit 2012	817 486
Pagesa e kesit te pare te apartamentit	(1 060 000)
Blerja e automjetit	(145 000)
Ndryshimi ne likuiditete	393 694
Hua nga M. M.	812 677
Shpenzime te vitit 2012	(599 259)
<b>Rezultati i vitit 2012</b>	<b>219 598</b>

32. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, është konstatuar gjithashtu se shtetasi A. H., - i cili i ka shitur subjektit të rivlerësimit automjetin në fjalë në datën 05.05.2012 në vlerën 145,000 Lekë, - e ka blerë më parë këtë automjet, sipas Faturës Nr. \*\*\*, datë 21.03.2012, me çmimin prej 1,467.41 Euro (ose ekuivalenti prej 205,027 Lekë)<sup>21</sup>. Po ashtu, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shitur këtë automjet në vitin 2017 me një çmim pak më të lartë se çmimi i blerjes në vitin 2012, konkretisht në vlerën 1,400 Euro (ose ekuivalenti prej 186,130 Lekë)<sup>22</sup>.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

33. Lidhur me diferencat e mësipërme në çmimin e blerjes dhe çmimin e shitjes, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se çmimi i blerjes së automjetit ka qënë 1,000 Euro, i cili është paguar në shumën prej 145,000 Lekë. Çmimi i blerjes ashtu dhe i shitjes janë pasojë vetëm e tregut dhe e asnjë faktori tjetër. Fakti se pse makina është shitur me një çmim me një diferencë të vogël sesa është blerë nga shitësi mund të kenë qënë problemet financiare apo probleme të tjera të tij, por që në këtë kontratë nuk ka ndikuar asnjë faktor tjetër veç tregut dhe gjendjes teknike të makinës. Si me shitësin e makinës ashtu dhe blerësin e saj subjekti shpjegon se nuk ka pasur njohje të mëparshme apo mëpasshme, konflikt interesi apo lidhje të tjera, pasi kanë qënë persona të rastësishëm<sup>23</sup>.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

34. Lidhur me diferencat e konstatuara me sipër, Komisioni vlerëson se, në mungesë të provës së kundërt, shpjegimet e subjektit se diferencat e çmimeve të lartpërmendura janë pasojë e dinamikës së tregut të lirë, dhe se nuk ka patur asnjë element influencues në përcaktimin e tyre që mund të lidhej më funksionin e subjektit të rivlerësimit, duken të pranueshme. Për më tepër që, nga hetimi administrativ dhe nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, nuk ka rezultuar asnjë konflikt interesash me personat që kanë qënë palë shitëse apo blerëse të kësaj pasurie, në veprimet juridike të kryera me subjektin. Në çdo rast, trupi gjykues çmon se problematikat e konstatuara lidhur me këtë pasuri, në vetvete, - pavarësisht se kanë qënë objekt hetimi dhe janë përfshirë në rezultatet e njoftuara nga Komisioni, duke

<sup>21</sup> Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit, ku 1 Euro këmbëhet me 139.72 Lekë.

<sup>22</sup> Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit, ku 1 Euro këmbëhet me 132.95 Lekë.

<sup>23</sup> Me shkresën Nr. \*\*\* Prot, datë 18.05.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe me shkresën Nr. \*\*\* Prot, datë 20.05.2020 Gjykata e Apelit Shkodër, kanë konfirmuar se nuk figurojnë çështje gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit në adresë të personave të përmendur në shkresë.

patur në vëmendje parimin e proporcionalitetit, - nuk mund të çonin gjithsesi në marrjen e ndonjë mase ndaj subjektit të rivlerësimi zj.Vojsava Osmanaj.

### **3. Lidhur me kursimet *cash* në banesë në vlerën 400,000 Lekë.**

35. Kjo gjendje *cash* në banesë është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP të vitit 2014, në të cilën burimi i krijimit përshkruhet nga kursimet nga paga<sup>24</sup>, nga dietat dhe të ardhura të tjera të vitit 2014. Ndërsa në Deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar po këtë gjendje të pandryshuar në banesë, por me burim kryesisht nga të ardhurat e realizuara nga punësimi dhe përfshirja në projekte të ndryshme, të paguara me lekë në dorë.
36. Gjithashtu, pikërisht lidhur me burimet e ndryshme, të deklaruara më herët për krijimin e gjendjes *cash* të disponuar në banesë, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se ajo ka një gjendje *cash* në banesë në shumën prej 400.000 lekësh, të cilën e mban për çdo lloj urgjencë apo nevojë familjare, shumë kjo e krijuar në vitin 2014 nga të ardhurat e atij viti, paga, mësimdhënia dhe pensionet e vajzës. Në vitet në vijim, subjekti sqaron se ka përfituar dhe të ardhura *cash* nga pjesëmarrja si eksperte në një projekt të Ambasadës Gjermane dhe në këtë periudhë ajo ka konsumuar një pjesë të kursimeve, të cilat i ka zëvendësuar me këto të ardhura. Duke qënë se nuk ka patur ndryshim të shumëve nuk i ka deklaruar më, dhe kjo ka qënë arsyeja që përveç të ardhurave të deklaruara ajo ka shtuar në vetting dhe lekët e marra nga projekti.
37. Bashkëngjitur me pyetësorin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin Nr. \*\*\*/2020, datë 19.05.2020, të lëshuar nga Qendra L.I.S.T, e cila ka informuar se subjekti i rivlerësimit është angazhuar nga periudha 01.01.2015 - 31.12.2016 si eksperte dhe është paguar në masën 359,322 Lekë bruto, nga të cilat 53,902 Lekë janë derdhur si tatim në burim për pagesën e marrë dhe vlera neto ka qënë 305,420 Lekë, pagesë kjo e kryer me para në dorë.
38. Nga sa më lart, Komisioni ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit në Deklaratën vetting me shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit nr 2, sa i përket burimit të krijimit të shumëve prej 400,000 Lekë, të disponuara *cash* në banesë. Gjithashtu, nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për disponimin e këtyre kursimeve *cash* prej 400,000 Lekë, në vitin 2014, me burime të ligjshme financiare.

### **4. Lidhur me gjendjen e likuiditeteve në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank dhe BKT, në masën 1,035,670 Lekë, me burim të deklaruar nga paga, dieta, pensioni i vajzës si dhe të ardhura nga mësimdhënia.**

39. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, është konfirmuar gjendja e llogarive sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në Deklaratën vetting si dhe burimi i krijimit

---

<sup>24</sup> KLGJ me shkresën Nr. \*\*\* prot, datë 28.05.2020, ka vënë në dispozicion të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit Vojsava Osmanaj për periudhën 18.03.2013- deri në 08.11.2016.

të gjendjeve në fjalë në llogaritë bankare pranë BKT dhe Raiffeisen Bank nga pagat, dietat, pensioni ushqimor për vajzën<sup>25</sup> dhe të ardhurat nga mësimdhënia të subjektit të rivlerësimit.

40. Nga sa më lart, Komisioni ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit në Deklaratën vetting për gjendjen e llogarive bankare dhe mbi burimin e krijimit të tyre me dokumentacionin e administruar, dhe nuk janë konstatuar pamjaftueshmëri financiare.

**5. Lidhur me shumën e dhuruar në vlerën totale prej 4,000 Euro, nga motra dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit.**

41. Kjo shumë është deklaruar si e dhuruar, për herë të parë në rubrikën e dhuratave dhe trajtimeve preferenciale të DIPP-së së vitit 2008, si dhuratë nga motra e subjektit, znj. Ç. O. në vlerën 2,500 Euro dhe të depozituara në llogarinë në USD të subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank, në masën 3,426 USD, si dhe dhuratë nga vëllai i saj, z. M. G., në vlerën prej 1,500 USD.

42. Në Deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat në fjalë si dhuratë nga motra dhe vëllai, të dhëna në vitin 2007 dhe të shpenzuara në vazhdimësi deri në vitin 2009, për nevoja personale. Në këtë deklaratë, vlerat e dhurimit janë deklaruar 2,500 Euro nga motra dhe 1,500 Euro (jo USD, si në vitin 2008) nga vëllai. Lidhur me mospërputhjen midis llojit të valutës së shumës së dhuruar nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, subjekti ka sqaruar, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se dhurimi ka qënë në shumën 1,500 Euro dhe se vendosja e shenjës së dollarit amerikan (\$) ka qënë një lapsus nga ana e saj në plotësimin e deklaratës së vitit 2008.

43. Në dokumentacionin bashkëngjitur Deklaratës vetting është paraqitur një shkresë e thjeshtë e motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ç. O., e cila mban datën 24.10.2016, në të cilën ka deklaruar se i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit në vitin 2007, shumën prej 2,500 Euro ndihmë për shkak të problemeve shëndetësore, si dhe një ndihmë të tillë ia ka dhënë edhe vëllai i tyre që jeton ne Greqi, z. M. G.

44. Lidhur me mosdeklarimin e shumave të dhuruara në DIPP të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se shumat janë marrë efektivisht të dyja në vitin 2008, dhe janë deklaruar prej saj në deklaratën përkatëse. Nga motra, leket i janë dërguar në fundin e vitit 2007 nëpërmjet një autobuzi të linjës (shoferit) dhe subjekti i ka marrë ato në janar të vitit 2008.

45. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ç. O., që kanë mundësuar dhënien e dhuratës në analizë, në shumën prej 2,500 Euro, në fund të vitit 2007, gjithmonë në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur edhe ekstraktin e të dhënave të sistemit/llogarisë të sigurimeve shoqërore<sup>26</sup> përkatëse në Itali, nga ku rezultojnë të ardhurat për vitin 2007 në masën 11,483 Euro. Gjithashtu janë paraqitur edhe fletët e pagave për muajt Qershor 2007 – Dhjetor 2007, nga

<sup>25</sup> Bazuar në Vendimin Nr \*\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, datë 03.10.2013, babai i vajzës së subjektit të rivlerësimit, shtetasi A. K., është ngarkuar me detyrimin për kontribut ushqimor për fëmijën A. K. në masën 15,000 Lekë në muaj. Ky detyrim ka filluar të transferohet nga A. K. në llogari të subjektit të rivlerësimit duke filluar nga viti 2014, përkatësisht 305,000 Lekë në 2014, 150,000 Lekë në 2015 dhe 210,000 Lekë në vitin 2016.

<sup>26</sup> Dokumentacioni “*Estratto conto Gestione Dipendenti Pubblici*” lëshuar nga Comune di Savona datë 15.10.2019, i pajisur me Vulë Apostile Nr \*\*\*, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.



të cilat ka rezultuar se gjatë vitit 2007, motra e subjektit të rivlerësimit ka përfituar të ardhura neto në masën 8,135 Euro. Pasi u përlogaritën nga Komisioni shpenzimet jetike<sup>27</sup>, në masën 5,287 Euro, ka rezultuar se dhuruesja ka patur mundësi të kursejë, përgjatë vitit 2007, me burime të ligjshme financiare, shumën prej 2,848 Euro. Rrjedhimisht, kishte mundësi për kryerjen e dhurimit të shumës prej 2,500 Euro, në favor të subjektit të rivlerësimit.

46. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. M. G., që i kanë mundësuar dhurimin e shumës prej 1,500 Euro, në fund të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit, bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka përcjellë pranë Komisionit, një vërtetim të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të Republikës së Greqisë, mbi pagesën e tatimit të fitimit për personat fizikë. Të ardhurat familjare të vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, në vitin 2007<sup>28</sup> kanë qënë në masën 20,100.10 Euro. Pasi u përlogaritën nga Komisioni dhe shpenzimet jetike<sup>29</sup>, në masën 12,852 Euro, ka rezultuar se dhuruesi ka patur mundësi të kursejë, përgjatë vitit 2007, me burime të ligjshme financiare, shumën prej 7,248.10 Euro. Rrjedhimisht, kishte mundësi për dhurimin e shumës prej 1,500 Euro subjektit të rivlerësimit.

47. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu një deklaratë të datës 19.05.2020, të lëshuar nga shtetasi M. G.<sup>30</sup>, me të cilën ai ka deklaruar se i ka dhuruar motrës së tij shumën prej 1,500 Euro në vitin 2008.

48. Në vijim të sa më lart, Komisioni ka konkluduar se personi tjetër i lidhur, znj. Ç. O., ka patur burime të ligjshme financiare që t'i dhuronte subjektit të rivlerësimit shumën prej 2,500 Euro, gjithashtu edhe personi tjetër i lidhur, z. M. G., ka patur mundësi që t'i dhuronte subjektit të rivlerësimit shumën prej 1,500 Euro, nga të ardhura me burime të ligjshme financiare.

**6. Lidhur me Automjetin e llojit Mercedes Benz C220, me targë \*\*\*, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. B. K.**

49. Pasuria e mësipërme është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP të vitit 2017, si pasuri e poseduar veçmas nga bashkëshorti, z. B. K.<sup>31</sup>, me burim të krijimit nga kursimet dhe nga paga gjatë viteve 2011 e në vazhdim, si dhe me kursimet familjare.

50. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit, z. B. K. ka blerë automjetin e llojit Mercedes Benz, tipi C 220CDi, viti i prodhimit 2011 sipas Faturës Nr. \*\*\*, datë 31.05.2017, nga shitësi z. E. R., kundrejt çmimit total prej 8,700 Euro (ose ekuivalenti prej 1,156,665 Lekë). Gjithashtu ka rezultuar se vetë z. E. R. e kishte blerë automjetin në fjalë, sipas faturës Nr. \*\*\*<sup>32</sup>, datë

<sup>27</sup> Bazuar në faqen e Eurostat <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>, sipas të cilës shpenzimet vjetore në Itali për vitin 2007 për një adult kanë qënë 9,064 Euro.

<sup>28</sup> Data e lëshimit të dokumentit është 18.07.2008 dhe data e lëshimit të kopjes është 19.05.2020.

<sup>29</sup> Bazuar në faqen e Eurostat <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>, sipas të cilës shpenzimet vjetore në Greqi për vitin 2007 për një familje me 2 fëmijë (sipas deklaratës çifti rezulton me 1 fëmijë) kanë qënë 12,852 Euro.

<sup>30</sup> Vëllai i subjektit të rivlerësimit ka ndërruar mbiemrin duke marrë mbiemrin e vajzërisë së nënës së tyre (G.), sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. \*\*\*, datë 05.07.1997, për të cilën subjekti ka paraqitur dhe çertifikatën familjare.

<sup>31</sup> Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në përgjigjet e pyetësorit nr 2, se bashkëjetesa me shtetasin B. K. ka filluar pas lindjes së vajzës së tyre, rreth muajit Nëntor 2017.

<sup>32</sup> Dokumenti original është në gjuhën italiane, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

18.04.2017, me çmimin 6,500 Euro (ose ekuivalenti prej 864,175 Lekë) dhe për të është paguar edhe detyrimi doganor në shumën 182,413 Lekë. Për rrjedhojë kostoja totale e blerjes së mjetit në analizë, nga pala shitëse (z. E. R.), ka rezultuar të ketë shkuar në vlerën 1,046,588 Lekë, duke mos lënë dyshime mbi përputhjen e veprimit juridik në fjalë më logjikën e tregut.

51. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, që kanë mundësuar blerjen e automjetit të lartpërmendur, subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri është pasuri e bashkëshortit dhe familjes së tij, e krijuar përpara martesës dhe bashkëjetesës së tyre, për të cilat vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë lidhje apo kontribut financiar. Megjithatë, ajo sqaron se është krijuar nga puna dhe të ardhurat dhe kursimet e ligjshme, të dokumentuara ose jo, të të gjithë familjes së bashkëshortit.
52. Fillimisht, duke analizuar burimet e deklaruara për blerjen e automjetit nga ana e z. B. K., dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka rezultuar se për periudhën dhjetor 2011 e deri në momentin e blerjes së automjetit në fjalë, Komisionit i rezultoi se të ardhurat totale bruto të z. B. K. ishin në vlerën 573,332 Lekë, të cilat nuk mjaftonin as të mbulonin shpenzimet e jetesës<sup>33</sup>. Gjithashtu, vëllai i tij, z. E. K., ka realizuar të ardhura për periudhën 2015 – Prill 2017, në shumën bruto prej 555,000 Lekë<sup>34</sup>. Ndërsa për babain e bashkëjetuesit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një ekstrakt të lëvizjeve të sigurimeve shoqërore në Itali, nga e cila rezulton se ai ka realizuar të ardhura gjatë viteve 2009, 2010, 2012 dhe 2014, shumën prej 17,245.83 Euro, të cilat, edhe në këtë rast, nuk arrijnë as të mbulojnë shpenzimet e tij të jetesës në Itali<sup>35</sup>.
53. Më pas, nga informacioni i ardhur nga ISSH me anë të shkresës Nr. \*\*\* Prot, datë 31.10.2019, ka rezultuar se z. L. K., është trajtuar me pension invaliditeti, duke filluar nga muaji Korrik i vitit 2005 e në vazhdim, në masën 8,521 Lekë në muaj, ndërsa e ëma e z. B. K. nuk rezulton të ketë përfituar të ardhura.
54. Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se me të ardhurat e provuara nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, dhe nga ato të administruara përgjatë hetimit administrativ, Komisioni konkludoi se z. B. K. dhe familjarët e tij, në vitin 2017, nuk kishin mjaftueshëm mundësi financiare për pagesën e plotë të çmimit të blerjes së këtij automjeti, me burime të ligjshme financiare.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

55. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, veç të tjerash, ka argumentuar dhe shpjeguar si më poshtë vijon:

---

<sup>33</sup> Referuar të dhënave zyrtare të publikuara nga INSTAT për periudhën në fjalë.

<sup>34</sup> Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion në përgjigje të pyetësorit nr. 2, një ekstrakt të nxjerrë nga e-albania. Ky dokument nuk përmban emrin e vëllait të bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit dhe nuk është i firmosur/vulosur.

<sup>35</sup> Referuar të dhënave në faqen zyrtare të Eurostat <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>, shpenzimet jetike për një person në Itali kanë qënë 2009 – 9,363 Euro, 2010 – 9,578 Euro, 2012 – 9,587 Euro dhe 2014 – 9,455 Euro.

- i. Së pari: kjo pasuri është një pasuri individuale e bashkëshortit, e blerë në vitin 2017, me të ardhurat nga puna dhe kursimet familjare në vitin 2017, duke qënë në këtë mënyrë jashtë periudhës së rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 84/2016.
  - ii. Së dyti: rezulton e provuar katërcipërisht se kjo pasuri është jashtë martesës ligjore me shtetasin z. B. K. (e cila sipas akteve zyrtare, çertifikatës së martesës lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë, rezulton se është lidhur në datë 25.09.2018) duke qënë në këtë mënyrë jashtë bashkësisë ligjore si dhe prezumimit ligjor të bashkëpronësisë.
  - iii. Së treti: ajo që është më e rëndësishme, kjo pasuri është e fituar edhe jashtë bashkëjetesës me këtë shtetas, e cila ka filluar në fund të vitit 2017, pas lindjes së vajzës, ku pasi kanë gjetur një banesë të përshtatshme për jetësen e të katërve, kanë nisur dhe bashkëjetesën ligjore, e cila është deklaruar rregullisht prej saj në DIPP të vitit 2017, dorëzuar në ILDKPI në datë 27.04.2018. Në këtë deklaratë, duke marrë në konsideratë fillimin e faktit të bashkëjetesës, në kuptim të nenit 163 të Kodit të Familjes, ka deklaruar në rubrikën “Deklaratë e interesave private të personit të lidhur” pasurinë vetjake të bashkëjetuesit, e cila disponohet veçmas.
  - iv. Është jashtë llogjikës juridike që të ngarkosh një person me barrë prove lidhur me burimin e ligjshëm të pasurisë, për shkak se personi me të cilën ai ka një lidhje blen një pasuri të caktuar individuale.
  - v. Në kohën e krijimit të kësaj pasurie, shtetasi B. K., nuk e gëzonte statusin e bashkëshortit, as të bashkëjetuesit, e aq më pak statusin e personit të lidhur të një subjekti rivlerësimi, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Për shkak të kësaj situatë, subjekti vlerëson se nuk ka ndonjë detyrim ligjor të provojë burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.
56. Gjithsesi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa prova të reja lidhur me burimet e krijimit të pasurisë në fjalë, duke çmuar se shtetasi B. K. ka patur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë pasuri (edhe pse jo në kuptim të ligjit nr. 84/2016) duke konsideruar se në përputhje me barrën e provës që është kaluar nga Komisioni, ka provuar të ardhura të ligjshme të tyre dhe mundësinë për të blerë këtë pasuri, e cila është një pasuri individuale para martese e bashkëjetese.
57. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Komisionit, në cilësinë e provave te reja, dokumentacionin si më poshtë:
- i. Vërtetim Nr. \*\*\* Prot, datë 17.08.2020 lëshuar nga “\*\*\*\*” Sh.p.k., në të cilën është shprehur se shtetasi B. K. ka qënë punonjës pranë kësaj shoqërie për periudhën shtator 2012 - qershor 2014 me kontratë individuale pune vjetore të rinovueshme dhe se gjatë kësaj periudhe është shpërblyer privatisht nga administratori dhe menaxherët me vlera monetare prej 50,000 Lekë në muaj.
  - ii. Deklaratë me vërtetim nënshkrimi Nr. \*\*\* Rep, datë 20.08.2020, lëshuar nga I. O., i cili në cilësinë e pronarit të aktivitetit me emër tregtar “\*\*\*\*”, me aktivitet “Klub nate 24 orë”, ka deklaruar se B. K. ka punuar si menaxher i klubit për periudhën janar 2010 – dhjetor 2013, gjatë turnit të natës dhe është paguar me 50,000 lekë në muaj, shumë e cila është dhënë cash bazuar në marrëveshjen midis tyre.

iii. Deklaratë noteriale Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 20.08.2020, lëshuar nga shtetasi T. H., i cili ka deklaruar se ka qenë administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” Sh.p.k., me NIPT \*\*\* dhe se B. K. ka punuar gjatë periudhës korrik 2014 – dhjetor 2015 si menaxher dhe është paguar me vlerën 60,000 Lekë në muaj, shumë e cila është dhënë cash bazuar në marrëveshjen midis tyre.

Vetëdeklarim me vërtetim nënshkrimi Nr. \*\*\* Rep., datë 11.08.2020 të shtetasit Gim Kumbulla, i cili ka deklaruar se ushtron aktivitetin e tij në Itali në fushën e ndërtimit dhe se shtetasi L. K. ka punuar në këtë kompani si punëtor ndërtimi dhe hidraulik, por është siguruar për një periudhë të shkurtër, me kërkesën e tij, për të rinovuar dokumentat dhe më pas ka vazhduar në të zezë, punë për të cilën është paguar 1,500 Euro në muaj.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

58. Komisioni, lidhur me këtë pasuri, të krijuar përpara bashkëjetesës dhe martesës, nga një person që në momentin e blerjes nuk ishte person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për sa kohë nuk ka rezultuar ndonjë kontribut i këtij të fundit (subjektit), vlerëson se edhe në rast pamundësie financiare, në kuptimin e nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës, të blerësit të sendit, nuk mund të përbëjë shkak penalizimi të znj. Osmanaj, në mungesë të elementeve ndërlidhës të pasurisë në fjalë me të. Fakti që kjo pasuri dhe mënyra e krijimit të saj kanë qenë objekt i hetimit administrativ, rrjedh nga nevoja e Komisionit për të kryer një hetim gjithëpërfshirës, - pikërisht për të qartësuar dinamikën e përfitimit të mjetit të deklaruar, - pa të cilin nuk mund të vlerësohej përfshirja e mundshme e subjektit.
59. Gjithashtu, në konsiderim dhe analizim të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, është vërejtur një mundësi e shumëfishtë të ardhurash të familjes K., të cilat edhe pse jo të gjitha mund të vlerësohen si burime të ligjshme në kuptimin e nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës, japin një panoramë të një disponibiliteti të mundshëm financiar për blerjen e automjetit në vitin 2017.
60. Së fundmi, Komisioni çmon se, edhe nëse pamjaftueshmëria e burimeve financiare për blerjen e pasurisë në fjalë do të përfshinte edhe subjektin e rivlerësimit, e parë veçmas nën këndvështrimin sasior (të mungesës financiare), si dhe duke mbajtur në vëmendje parimin e proporcionalitetit, do të konsiderohej jo e mjaftueshme për të passjellë aplikim e një mase disiplinore.

### **7. Truall 500 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sipërfaqe 148.30 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Tiranë.**

61. Komisioni ka administruar shkresën e ASHK Tiranë, me Nr. \*\*\* Prot, datë 25.11.2019, nëpërmjet të cilës ka informuar se në emër të shtetasit L. K. (babai i bashkëshortit të subjektit) figuron e regjistruar pasuria truall me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sipërfaqe 148.3 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, ndodhur në ZK \*\*\*, vol \*\*\*, faqe \*\*\*.
62. Ka rezultuar se kjo pasuri është blerë me anë të kontratës Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 16.10.1997, me palë blerëse L. K. dhe V. K. dhe palë shitëse R. dhe V. B., kundrejt çmimit 1,900,000 Lekë.

63. Në dokumentacionin e ardhur nga ASHK Tiranë, ka rezultuar se shtetasi L. K. ka nënshkruar një deklaratë noteriale Nr. \*\*\* Rep, Nr. \*\*\* Kol, datë 09.12.2016, ku ka informuar se shtëpia e blerë në vitin 1997 ishte bërë e pabanueshme dhe mbi të njëjtat themele ka ndërtuar një godinë të re, për legalizimin e të cilës ka aplikuar në datën 22.03.2005. Gjithashtu ka rezultuar se pasuria në fjalë është legalizuar me anë të Lejes së legalizimit Nr \*\*\*, në datë 02.02.2017 dhe është bërë edhe regjistrimi i saj në ASHK, në datën 09.02.2018.
64. Komisioni i ka drejtuar pyetje subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, që në përgjigje të pyetësorit nr. 2, është shprehur se pasuria në fjalë është pronë e familjes e fituar dhe e ndërtuar vite më parë, për të cilën ajo nuk ka asnjë lidhje apo kontribut, apo të ketë banuar ndonjëherë në të. Kjo familje, si çdo familje shqiptare kanë punuar dhe jetuar duke nxjerrë të ardhura të ligjshme, si të dokumentuara ose jo, dhe nuk kanë asnjë lidhje me subjektin apo punën e saj. Arsyeja se pse është deklaruar kjo banesë në pasuritë e disponuara veçmas, ka qënë se ajo nuk e dinte mënyrën se si do të përcaktohej pronësia mes tyre (nëse do të ishte vetëm kryefamiljari apo gjithë familja) dhe është deklaruar për të shmangur ndonjë përgjegjësi për mosdeklarim të mundshëm. Subjekti deklaroi se nga momenti i njohjes me bashkëshortin, madje dhe shumë vite para, banesa nuk ka patur asnjë investim apo ndryshim në strukturë apo brenda. Nga fotografimet ajrore, Ortofotot<sup>36</sup> e realizuara nga geoportal.asig.gov.al ka shkëputur fotot ajrore të kësaj banese që para viteve 1990, të vitit 1994, 2007, 2015, 2018 dhe 2019, ku duket qartë banesa fillimisht pa çati, dhe nga viti 2006 me çati me papafingo me asnjë lloj ndryshimi apo investimi në të deri më sot.
65. Në vijim të sa më lart, dhe në konkluzion të hetimit administrativ, trupi gjykues i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit dhe mbërriti në përfundimin se investimet e kryera nga familja e bashkëshortit të subjektit për blerjen dhe ndërtimin e pasurisë në fjalë, janë kryer shumë kohë përpara fillimit të bashkëjetesës dhe martesës së subjektit të rivlerësimit me shtetasin B. K., dhe për rrjedhojë, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>37</sup>, analizimi i burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, nuk përfshihet në tagrin rivlerësimit kalimtar të subjekteve, sipas ligjit nr. 84/2016.

## **REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE**

66. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre, është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës.
67. Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të

<sup>36</sup> Ortofotot ajrore të marra nga portali qeveritar për vitet para 1990, 1994, 2007, 2015, 2018 dhe 2019. Konstatohet nga këto foto se nga viti 2007, nuk ka ndryshime në ndërtimin e jashtëm të pasurisë.

<sup>37</sup> Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 4/2020 dhe nr. 7/2020.

Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2007, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar ka rezultuar një bilanc pozitiv, pa mungesa të burimeve financiare.

### Analiza financiare për periudhën 2007-2016:

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>71 958</b>	<b>260 462</b>	<b>15 064</b>	<b>-240 172</b>	<b>288 578</b>	<b>811 306</b>	<b>1 995 771</b>	<b>495 248</b>	<b>535 186</b>	<b>669 156</b>
Apartament banimi 78,5 m2, Pogradec						1 060 000	1 940 000			
Automjet Mercedes Benz, viti 2000						145 000				
Ndryshim likuiditeti	71 958	260 462	15 064	-240 172	288 578	-393 694	55 771	495 248	535 186	669 156
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>71 958</b>	<b>332 420</b>	<b>347 484</b>	<b>107 312</b>	<b>395 891</b>	<b>2 197</b>	<b>57 968</b>	<b>553 216</b>	<b>1 088 402</b>	<b>1 757 558</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>612 677</b>	<b>1 614 300</b>	<b>-351 600</b>	<b>-350 919</b>	<b>-190 920</b>
Hua nga Myfterem Mici 1,000,000 Leke						612 677	-240 000	-240 000	-240 000	-80 000
Kredi ne BKT 1,938,000 Leke							1 854 300	-111 600	-110 919	-110 920
<b>PASURI NETO</b>	<b>71 958</b>	<b>260 462</b>	<b>15 064</b>	<b>-240 172</b>	<b>288 578</b>	<b>198 629</b>	<b>381 471</b>	<b>846 848</b>	<b>886 105</b>	<b>860 076</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>522 827</b>	<b>1 281 870</b>	<b>849 220</b>	<b>937 135</b>	<b>1 101 268</b>	<b>817 486</b>	<b>1 229 691</b>	<b>1 606 701</b>	<b>1 695 444</b>	<b>1 797 334</b>
Të ardhura SR deklaruar	552 000	1 217 784	865 592	705 479	1 110 268	818 486	1 536 691	1 924 201	2 557 459	1 880 899
Paga SR vertetuar	522 827	1 281 870	849 220	937 135	1 101 268	817 486	1 229 691	1 606 701	1 695 444	1 797 334
<b>SHPENZIME</b>	<b>153 025</b>	<b>200 004</b>	<b>231 230</b>	<b>281 083</b>	<b>359 274</b>	<b>399 259</b>	<b>606 127</b>	<b>711 635</b>	<b>551 906</b>	<b>885 429</b>
Shpenzime jetese	123 089	136 620	170 775	273 240	273 240	282 048	282 048	439 996	448 552	470 184
Shpenzime qiraje							180 000	195 000	60 000	280 000
Shpenzime zhdoganimi automjeti							30 823			
Shpenzime udhetimi	29 936	63 384	60 455	7 843	86 034	48 188	80 906	32 895	0	59 181
Komisione dhe shpenzime sigurimi per kredine							24 973	5 544	5 154	5 864
Shpenzime per arsimin e femijeve										32 000
Shpenzime arredimi / mobilimi ne Pogradec						38 200	38 200	38 200	38 200	38 200
Shpenzime per regjistrimin e apartamentit							6 150			
Analiza dokumentuar	297 844	821 404	602 926	896 224	453 416	219 598	242 093	48 218	257 433	51 829
CASH në lekë								400 000	400 000	400 000
<b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>	<b>0</b>									

### B. KONTROLLI I FIGURËS

68. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit, me Nr. \*\*\* Prot, datë 31.10.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Vojsava Osmanaj. Gjithashtu, me shkresën e datës 08.10.2019, DSIK i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht, më datë 04.10.2019 me vendimin e KDZH-së nr \*\*\*.

69. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte të reja lidhur me këtë kriter. Për rrjedhojë, Komisioni – pas hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016 dhe bazuar në dokumentet e administruara, – në vlerësim të kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, arrin në përfundimin se nuk janë gjetur fakte apo rrethana që mund të çonin në një konkluzion të ndryshëm nga ai i arritur nga DSIK.

## C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

70. Komisioni në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLGJ –së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në:
- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGJ-ja, me nr. \*\*\* prot, datë 13.02.2020.
  - Informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncime të publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.
  - Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Lidhur me analizën e aftësive profesionale kryer nga KLGJ-ja**

71. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka konstatuar sa vijon.
72. Subjekti i rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj përgjatë periudhës së rivlerësimit, ka ushtruar detyrën e Inspektore pranë Inspektoratit të KLD –së, ndaj dhe raporti i lartpërmendur ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit të parashikuara në Vendimin nr. 36 datë 29.04.2015, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të Kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.
73. Znj. Vojsava Osmanaj në datën 24.01.2017, ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, aktet e mëposhtme: 1) Formulari i vetëdeklarimit, gjithsej 10 fletë; 2) 46 dokumente shoqëruese të Formularit të vetëdeklarimit, gjithsej 248 fletë dhe 1 libër të botuar si bashkëautore. 3) Lista e inventarit të akteve është pjesë e dosjes së rivlerësimit.
74. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet si më poshtë:
- Saktësia e Formularit të Vetëdeklarimit.

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, në mënyrë të plotë, i nënshkruar rregullisht, pa mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka paraqitur të dhëna duke iu referuar si periudhë vlerësimi viteve: 2013, 2014, 2015, 2016.

- Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit.

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në rubrikën “B” të Formularit, për periudhën Tetor 2007 – Mars 2013, subjekti Vojsava Osmanaj ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe është larguar për shkak emërimi Inspektore në Inspektoratin e KLD me Vendim nr. 312 datës

18.03.2013. Me dekret të Presidentit të Republikës nr. 8625 dt 08.11.2016, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku vazhdon të ushtrojë detyrën aktualisht.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit Vojsava Osmanaj ka deklaruar, se gjatë tre viteve të fundit ka ushtruar detyrën e Inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke ushtruar detyrën në Seksionin e Vlerësimit Etik dhe Profesional të gjyqtarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apeleve. Ajo ka deklaruar se ka kryer edhe detyra të tjera si përfaqësime të KLD- së, në gjykatë, inspektime tematike si dhe verifikime të ankesave.

75. Lidhur me këtë subjekt, KLGJ nuk ka konstatuar problematika dhe ka konkluduar se dokumentet ligjore dhe raportet konstatuese janë hartuar sipas formës standard të miratuar nga KLD. Ato përmbajnë të dhënat e individualizuara të gjyqtarëve të vlerësuar, si dhe analizën konkrete të tyre sipas rregullave të Sistemit të Vlerësimit. Gjuha e përdorur është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit, paragrafët janë të numërtuar me numra romakë, pikëzime dhe shifra, në mënyrë të qartë dhe të rregullt, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, lehtësisht të kuptueshëm pavarësisht faktit se raporti përpunon edhe të dhëna statistikore. Raportet përmbajnë datën e hartimit, emrin, funksionin e Inspektore dhe janë nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.
76. Gjithashtu, KLGJ është shprehur se subjekti ka aftësi shumë të mira për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale aktet në funksion të uniformizimit të praktikave. Kështu projektaktet e vlerësimit etiko profesional të gjyqtarëve [...] si dhe raportet verifikimet e ankesave [...] paraqiten të standartizuara. Inspektorja menaxhon mirë aftësitë e saj duke identifikuar natyrën e punës që duhet përmbushur. Në organizimin dhe planifikimin e punës ajo ka përballuar volum tepër të lartë ngarkese, referuar kjo edhe faktit të periudhës së rivlerësimit ku Inspektorati ka funksionuar me organikë të paplotësuar deri në 40 % mungesë.
77. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, dhe sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 Tetor 2013- 8 Tetor 2016”, për Inspektoren Vojsava Osmanaj nuk rezulton asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për këtë subjekt, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### **RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI**

78. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ -së si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.



## DENONCIMET NGA PUBLIKU

79. Pranë Komisionit, - bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, - për subjektin e rivlerësimit Zj.Vojsava Osmanaj, janë paraqitur nga publik 19 denoncime. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku, ka konstatuar se në përmbajtjen e pjesës më të madhe të tyre nuk janë evidentuar *indicie* apo elementë konkretë që mund të çonin në ndonjë shkelje procedurale apo në cënim të të drejtave të palëve. Ndërsa lidhur me denoncimet në të cilat janë gjetur *indicie* apo dyshime mbi elementë konkretë, janë kryer hetime të thelluara, duke administruar dosje hetimore dhe/ose gjyqësore, vendime specifike, si dhe akte të tjera, që ndërthureshin me referencat apo informacionet e denoncimeve në fjalë. Ndonëse në përfundim të shqyrtimit të tyre nuk janë konstatuar mangësi apo shkelje konkrete, në vijim po pasqyrohen disa prej tyre.

### **Lidhur me denoncimin nr. \*\*\* prot, datë 26.9.2019, i shtetases M. K.**

80. Denoncuesja në fjalë është ankuar ndaj 11 subjekteve të rivlerësimit, përfshirë aty edhe znj. Osmanaj, lidhur me aftësitë e tyre profesionale dhe për dhënien e vendimeve të padrejta. Nga shqyrtimi i materialeve që i janë bashkëlidhur denoncimit në fjalë, ka rezultuar se shtetasi E. K. (djali i denoncueses), dhe z. R. I., janë akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasje me paramendim, kryer në bashkëpunim” dhe “Mbajtje pa leje të armëve të gjahut”.

81. Nga dokumenti i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.11.2012, ka vendosur: 1. *‘Deklarimin fajtor të të pandehurit E. K. për veprën penale të “Vrasje me paramendim, kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 78/2 të K. Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.* 2. *Deklarimin fajtor të të pandehurit E. K. për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë”, parashikuar nga neni 280 të K. Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim.* 3. *Në zbatim të nenit 55 të K. Penal, dënimin e të pandehurit E. K. në bashkim të dënimeve për veprat penale me burgim të përjetshëm.* 4. *Vuajta e dënimit fillon nga data e ndalimit, në një burg të sigurisë së lartë.* 5. *Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale që i atribuohet të pandehurit R. I., duke e cilësuar atë nga “Vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim”, e parashikuar nga neni 78/1 i K. Penal, në vepëren penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, e parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij për këtë vepër me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.* 6. *Deklarimin fajtor të të pandehurit R. I. për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë”, parashikuar nga neni 280 të K. Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.* 7. *Në zbatim të nenit 55 të K. Penal, dënimin e të pandehurit R. I. në bashkim të dënimeve për veprat penale me 2 (dy) vite burgim.* 8. *Vuajta e dënimit fillon nga data e ndalimit, në një burg të sigurisë së zakonshme.* 9. *Provat materiale konkretisht [...]*

82. Pokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka ankimuar vendimin e lartpërmendur, duke kërkuar “Prishjen e vendimit për sa i përket të pandehurit R. I. dhe deklarin për veprën penale të “Vrasje me paramendim”, dhe dënimin e tij me 25 vjet burg. Më tej ka paraqitur ankim edhe i pandehuri E. K. duke kërkuar prishjen e vendimit dhe deklarin e pafajshëm.

83. Pas ankimit të bërë në Gjykatën e Apelit Shkodër, kjo gjykatë me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.4.2013, ka vendosur *“Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 15.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”*. Gjykata e Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.3.2016, ka vendosur *“Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 15.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues”*.
84. Nga ana e Komisionit, është evidentuar se subjekti i rivlerësimit Vojsava Osmanaj ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupës në rigjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, e cila ka çmuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi përsa i përket deklarimit fajtor, dhe cilësimit të veprës penale dhe masës së dënimit për të pandehurin E. K., si dhe deklarimin fajtor dhe cilësimin ligjor për të pandehurin R. I., por duhet të ndryshohet në lidhje me masën e dënimit për këtë të fundit, duke e dënuar me 3 (tre) vite burg, si dhe duhet të prishet dhe të pushohet çështja penale për sa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 280 i K. Penal, për shkak të ligjit për amnistinë.
85. Nga sa më sipër, Gjykata me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 23.3.2017, ka vendosur: *‘Lënien në fuqi e vendimit nr. \*\*\*, datë 15.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sa i përket disponimit për pikat 1, 4,8,9,10 të tij. Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes penale për të pandehurit E. K. dhe R. I. sa i përket veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga neni 280 i K. Penal, për shkak të ligjit “Për Amnistinë”. Ndryshimin e pikës 5, të dispozitivit të vendimit për të pandehurin R.I. dhe dënimin e tij me 3 (tre) vite burgim.’*
86. Nga vlerësimi i fakteve të denoncuar si dhe të vendimeve të lartpërmendura, nuk janë konstatuar shkelje procedurale, ose të drejtave të palëve, apo arsyetim të dobët dhe/ose të paplotë/munguar, që mund të ishin kryer nga trupi gjykues, ku ishte pjesë edhe subjekti i rivlerësimit. Lidhur me pretendimet e denoncuesit mbi aludime të një vendimi të padrejtë, Komisioni konstaton se ato ngrihen mbi themelin e vendimit, rrethanë kjo që nuk është objekt shqyrtimi përgjatë procesit të rivlerësimit.

**Lidhur me denoncimin nr. \*\*\* prot, datë 15.07.2020 nga Av. A.Gj.**

87. Nëpërmjet këtij ankimi, avokati-denoncues pretendon se përgjatë zhvillimit të një procesi penal, - në të cilin ai ka përfaqësuar shtetasin me inicialet A.A, - në datën 08.07.2020 ai është njoftuar nga sekretaria gjyqësore, nëpërmjet një komunikimi telefonik, se në datën 09.07.2020 ora 11.20, do të zhvillohej seanca e radhës gjyqësore për çështjen në fjalë. Sipas tij, ai ka bërë me dije se nuk do të ishte prezent (për arsye familjare) si dhe ka dërguar një e-mail në adresën e sekretarisë gjyqësore duke kërkuar shtyrjen e kësaj seance. Denoncuesi pretendon gjithashtu se, më pas, ai është njoftuar se seanca gjyqësore e lartpërmendur, ishte zhvilluar në datën e parashikuar, duke shpallur edhe vendimin përkatës për: *“Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”*. Avokati pretendon se në këtë rast ka patur shkelje procedurale nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi nuk janë respektuar parimet bazë të njoftimi të palëve në proces, si dhe se nga kjo Gjykatë nuk është marrë në konsideratë një *“raport mjekësor”*, dokument ky,

siaps tij, i depozituar pikërisht për shtyrjen e seancës gjyqësore. Gjithashtu, ai shprehet se trupi gjykues e ka zëvendësuar atë (avokatin-denoncues), me një avokat tjetër kryesisht. Denoncuesi nuk ka depozituar kurrfarë dokumentacioni lidhur me pretendimet e ngritura prej tij.

88. Komisioni, në vijim të shqyrtimit të këtij denoncimi, ka administruar nga Gjykata e Apelit Shkodër, më datë 07.08.2020, procesverbalet e seancave gjyqësore të zhvilluara për çështjen në fjalë si dhe vendimin përkatës. Gjithashtu Komisioni, nëpërmjet rezultateve të hetimit, i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, lidhur me shkeljen e mundshme të të drejtave të mbrojtjes së të pandehurit, ndaj të cilit është konfirmuar vendimi i shkallës së parë, pa pjesëmarrjen në seancën gjyqësore të mbrojtësit të zgjedhur prej tij, por me prezencën e një avokati të caktuar kryesisht nga Gjykata e Apelit Shkodër.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

89. Pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është shprehur, se avokati-denoncues është njoftuar lidhur me seancat disa herë nga sekretaria gjyqësore (edhe nëpërmjet telefonit, duke mbajtur procesverbalet përkatëse). Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit është shprehur se është respektuar me rigorozitet procedura për njohjen e avokatit me fashikullin e çështjes, veprim ky i realizuar në ambjentet e gjykatës në fjalë, pas paraqitjes së tij dhe në prezencën e sekretares gjyqësore, përgjatë gjithë kohës së njohjes me materialin e dosjes. Veç të tjerash, subjekti referon disa tërheqje të vëmëndjes që i janë bërë këtij avokati, edhe me shpresë zyrtare, për shkak të mungesave të shumta në gjykimin e kësaj çështje. Sipas subjektit, kjo qasje e avokatit në fjalë ka shkaktuar zvarritjen (e qëllimshme) të procesit, për sa kohë mosparaqitjet e tij në seancat gjyqësore nuk kanë qenë (gjithmon) të justifikuara. Nga ana tjetër Gjykata ka patur detyrimin e përfundimit të gjyimit në fjalë në respekt të afateve të parashikuara dhe sidomos përpara se të skadonin afatet e paraburgimit. Në këto rrethana, sipas subjektit, trupi gjykues ka gjetur një ekuilibër midis respektimit të afateve procedurale dhe të drejtave të palëve, pa lejuar zvarritjen e procesit gjyqësor me pasoja skadimin e afateve të lartpërmendura.
90. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit, një kopje të plotë të të gjitha akteve procedurale të realizuara prej saj, në cilësinë e relatores së kësaj çështje, edhe lidhur me njoftimin e: (i) të pandehurit A. A.; (ii) të avokatit të zgjedhur prej tij, z. A. Gj.; (iii) të avokatit të caktuar kryesisht nga Gjykata; si dhe procesverbalet e seancave gjyqësore dhe aktet e tërheqjes së vëmëndjes, të kryera ndaj avokatit Gj., për shkak të mungesave të shumta të tij në seancat e gjyimit të kësaj çështje, duke shkaktuar zvarritjen e saj. Lidhur me seancën e cituar nga denoncuesi, subjekti ka referuar se avokati-denoncues, ndonëse ka kërkuar shtyrjen e kësaj seance për arsye familjare, nuk ka përcjellë asnjë dokument justifikues, që mund provonte pamundësinë e tij për t'u paraqitur në seancën radhës, dhe për rrjedhojë të mund të legjitimonte edhe Gjykatën për një tjetër shtyrje të seancës gjyqësore.
91. Në mbështetje të shpjegimeve të saj subjekti i rivlerësimit, ka vënë në dispozicion një kopje e akteve që provojnë komunikimet ndaj avokatit në fjalë, si për seancat e zhvilluara, por edhe për të marrë një kopje të akteve në dosje, për të cilat avokati-denoncues, pasi

është njohur me to, ka shprehur dakortësinë në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 27.02.2020, për zhvillimin e seancës gjyqësore të rradhës.

92. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit edhe aktet e mëposhtëme:
- i. Urdhër për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore nr. \*\*\* datë 12.11.2019; listën e gjyqeve shtesë që gjykohen nga kjo gjyqtare;
  - ii. Praktikën drejtuar KLGJ, Tiranë për caktimin e një gjyqtari datë 04.06.2020;
  - iii. Njoftimet drejtuar I EVP (Elbasan. dhe Burrel dhe Komisarariatit Shkodër) përkatëse dhe njoftimet drejtuar Av. A. Gj;
  - iv. Kopje të postës elektronike të njoftimit të Av. A. Gj si dhe kthim përgjigjet e sekretarisë së Gjykatës së Apelit Shkodër, për njoftimin e këtij të fundit, për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore;
  - v. Kopje të procesvebaleve të seancave gjyqësore; procesverbalet mbi komunikimet telefonike, të mbajtura nga sekretaria gjyqësore për njoftimin e avokatit mbrojtës dhe marrjen dijeni të këtij të fundit datë 08.07.2020 dhe zhvillimin e seancës gjyqësore në datë 09.07.2020;
  - vi. Kopje të postës elektronike të sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Apelit Shkodër;
  - vii. Procesverbalin e datës 9.07.2020 në të cilin konstatohet se av. A. Gj. nuk ka qënë prezent, edhe pse është njoftuar nga sekretaria e Gjykatës (*në procesverbal evidentohet se është njoftuar asistentja e tij si dhe është njoftuar nga kjo e fundit se nuk do të ketë më njoftim tjetër nga Gjykata*), për datën dhe orën e zhvillimit të seancës;
93. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Shkodër në datën 09.07.2020, datë e përcaktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, ka konsideruar si të papërligjur kërkesën e avokatit duke vazhduar gjykimin<sup>38</sup> në mungesë të tij, por me prezencën e një avokati të caktuar kryesisht që ishte njohur me dosjen në fjalë, - bazuar në nenin 351 të K. PR. Penale.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

94. Duke u bazuar në sa më lart nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe shpjegimet e dhëna, rezulton se denoncimi i avokatit A. Gj. për shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Osmanaj është i pabazuar, dhe se janë respektuar dhe garantuar të gjitha të drejtat e të pandehurit si dhe të mbrojtësit të zgjedhur prej tij në çështjen objekt vlerësimi. Rrjedhimisht nuk ka rezultuar ndonjë shkelje procedurale, ose të të drejtave të palëve, apo arsyetim të dobët dhe/ose të paplotë/munguar, që mund të ishin kryer nga trupi gjykues, ku ishte pjesë edhe subjekti i rivlerësimit.

#### **Lidhur me denoncimin nr. \*\*\* prot, datë 23.09.2019 i shtetases J. K.**

95. Denoncuesi J. K., është ankuar ndaj subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar me vendimin e dhënë prej tij, i ka shkaktuar pasoja të rënda të pariparueshme lidhur me një

---

<sup>38</sup>Referoju kopjes së procesverbalit të datës 09.07.2020.

padi për pjestimin e pasurisë së ndodhur në Korçë. Ka rezultuar se shtetasi J. K. ka ngritur një padi me objekt “*Kundërshtimin e veprimeve përmbare si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë*”, çështje kjo e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, dhe e vendosur me vendimin nr. \*\*\*, datë 01.04.2011, nëpërmjet të cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka vendosur rrëzimin e padisë të paditësit J. K. për të gjitha kërkimet e tij si të pa bazuar në prova dhe në ligj.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

96. Lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit ka analizuar dhe shpjeguar se pretendimet e denoncuesit lidhen me vendimarrjen e lartpërmendur, në periudhën e punës së saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, duke sqaruar se denoncuesi ka qënë në cilësinë e paditësit në këtë gjykim civil. Pretendimet e tij kryesisht lidhen me vendimarrjen e subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka paraqitur në ankimin e tij duke depozituar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, ankimin e tij. Kjo Gjykatë me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.09.2011, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 01.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë “të dhënë nga subjekti i rivlerësimit”. Në mbështetje të shpjegimeve të veta, subjekti ka paraqitur një kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 15.09.2011 të Gjykatës së Apelit Korçë, që ka gjetur të bazuar vendimin e saj.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

97. Në në vijim të analizës dhe të shqyrtimit të fakteve, rrethanave dhe dokumenteve të sipërpërmendura dhe të dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues çmon se edhe në këtë rast subjekti i rivlerësimit ka vepruar sipas dispozitave ligjore. Ndonëse konstatohet se denoncimi i shtetasit J. K, ka të bëjë me themelin e çështjes dhe vendimarrjen e subjektit të rivlerësimit, që nuk mund të jetë në vetvete si objekt shqyrtimi, përgjatë procesit të rivlerësimit, vërehet se as në këtë rast nuk ka rezultuar ndonjë shkelje procedurale, ose e të drejtave të palëve, apo ndonjë arsyetim të dobët dhe/ose të paplotë/munguar nga subjekti i rivlerësimit.
98. Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet e bëra nga KLGj-ja, lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit, nuk kanë rezultuar problematika, shkelje apo mangësi profesionale të znj. Vojsava Osmanaj.
99. Në këto kushte, trupi gjykues, duke çmuar faktet dhe rrethanat e sipërcituara, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj, ka arritur një nivel më se kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit ligjor përkatës.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

3. ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj, duhet të konfirmohet në detyrë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Vojsava Osmanaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në datën 21.7.2020.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Suela Zhegu**  
**Kryesuese**

**Lulzim Hamitaj**  
**Relator**

**Genta Tafa (Bungo)**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*